



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 28.07.2016

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “QENDËR TREGTARE**  
**“VLLAZNIA”, BASHKIA SHKODËR”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Arbi Group” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Qendër Tregtare “Vllaznia”, Bashkia Shkodër”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Arbi Group” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor;
  - a) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOJA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

